

POLITIKAT E PRIVATËSISË TË QENDRËS “TË NDRYSHËM & TË BARABARTË” DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

1. Informacion i përgjithshëm për D&E

Qendra “Të Ndryshëm & Të Barabartë” (D&E) është organizatë shqiptare jofitimprurëse (OJF) e krijuar në maj të vitit 2004 dhe ofron shërbime parandaluese, mbrojtëse dhe riintegruese për viktimat e trafikimit, viktimat e abuzimit seksual, viktimat e dhunës, si dhe grupet vulnerabël.

Planifikimi dhe zbatimi i aktiviteteve të organizatës “Të Ndryshëm & Të Barabartë” udhëhiqen dhe përbushin linjat e strategjive dhe planeve kombëtare të veprimit për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, kundër abuzimit seksual, dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, si dhe detyrimet e organizatës si Anëtare e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për viktimat e trafikimit.

Vizioni i D&E: “Ne besojmë në një shoqëri pa trafikim, shfrytëzim apo diskriminim, ku çdo njeri i respektohen të drejtat dhe i jepen mundësi të barabarta”.

Misioni i D&E: D&E është një organizatë jo-fitimprurëse e përkushtuar për të dhënë shërbime cilësore për mbrojtjen dhe ri/integrimin e viktimave të abuzimit, të shfrytëzimit dhe të trafikimit dhe për të kontribuar në ndryshimin e kontekstit ligjor, institucional dhe social në mënyrë të tillë që ti kundërshtojë këto abuzime.

Aktivitetet dhe shërbimet e ofruara nga D&E:

- Shërbimet rezidenciale dhe komunitare;
- Aktivitete për të lehtësuar dhe rritur aksesin e viktimave në shërbimet publike;
- Ndërgjegjësimi i komunitetit për pasojat e dhunës dhe trafikimit dhe të drejtat e viktimave;
- Veprimtaritë për vlerësimin e tregut formal të punës dhe rritjen e aksesit të viktimave në të;
- Mbështetje teknike dhe financiare për gjenerimin e të ardhurave dhe vetëpunësimin e viktimave;
- Aktivitete për të luftuar stigmën dhe diskriminimin ndaj viktimave të dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë viktimat e trafikimit dhe ato të abuzimit seksual;

- Trajnime për OJQ-të, institucionet shtetërore dhe kompanitë e biznesit;
- Studime dhe vlerësime të procesit të riintegrit të viktimave të dhunës me bazë gjinore;
- Pjesëmarrja në procesin e identifikimit të viktimave;
- Lobimi dhe Avokimi;
- Mbështetje për politikë-bërësit
- Parandalimi – Rritja e ndërgjegjësimit; fuqizimi i grupeve vulnerabël
- Informacion dhe këshilla teknike për hartimin e ligjeve dhe legjisllacionit për mbrojtjen e fëmijëve, viktimave të trafikimit dhe dhunës në familje.

2. Informacioni që grumbullohet nga vizitorët dhe politikat e sigurisë

D&E nuk mbledh informacion personal për vizitorët e faqes sonë të internetit, nëse vizitori/ja nuk dëshiron të ndajë këtë informacion me ne.

Shkëmbimi apo dorëzimi i një informacioni nëpërmjet faqes sonë të internetit apo nëpërmjet kontakteve të D&E në mënyrë vullnetare nga ana juaj, nënkupton që ju keni dhënë lejen tuaj për ta përdorur këtë informacion për qëllimin e deklaruar dhe në funksion të misionit të përgjithshëm të organizatës D&E.

Për çdo të dhënë që ju dërgoni apo informacion të ndarë me ne, me një nga mjetet e komunikimit, D&E respekton të drejtën tuaj për ruajtjen e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale sipas standardeve ligjore të parashikuara në Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

D&E përpunon automatikisht dhe mban emrin e fushës nga ku ju keni akses në Internet, datën dhe kohën kur ju vizitoni faqen tonë të internetit; adresën e Internetit të faqes (duke përfshirë faqen e kërkimit google ose faqen referuese) nga e cila ju mbërritët në faqen tonë. D&E e përdor informacionin e grumbulluar për të numëruar vizitorët e faqes tonë si dhe për të na ndihmuar ne për ta bërë faqen tonë më të dobishme për vizitorë si ju.

3. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit

D&E dhe i gjithë stafi i saj, përpunuesit/et dhe personat e tretë të kontraktuar nga D&E që kanë akses në të dhënat e marra prej jush apo që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, si dhe pas përfundimit të marrëdhënieve të punës apo bashkëpunimit me D&E, janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

4. Kontakte të D&E

Organizata “Të Ndryshëm dhe Të Barabartë”

Tel: +355 (4) 222 18 92

E-mail: contact@differentandequal.org

Adresa:

Rr: “Fortuzi”, Godina nr. 24, Hyrja nr.4, Apartamenti. nr.4 , Tiranë, Shqipëri.

Shënim: Për dërgimin e mesazhit tuaj ju mund të na kontaktoni edhe në rubrikën “Na kontaktoni”.

5. E drejta e aksesit, refuzimit të pëlqimit të dhënë dhe e korrektimit të të dhënave

Në rast se nuk është dhënë paraprakisht, ju keni të drejtë të kërkonti informacion për qëllimin dhe destinacionin e informacionit të dërguar prej jush, si dhe gjithmonë keni të drejtë të aksesoni të dhënat dhe informacionin e dërguar pranë D&E. Në çdo kohë ju keni të drejtë të refuzoni dhënien e një informacioni apo edhe të kërkonti korrigjimin apo korrektimin e tij.

Për çdo ndryshim apo përditësim të politikave të privatësisë ju do të njoftoheni nëpërmjet faqes sonë të internetit, informacion i cili gjendet i publikuar në rubrikën “Politikat e Privatësisë”.